



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 19.12.2018, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja - kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Vizitë informuese në institucionin e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Tematika e vizitës:

1. Informacion në lidhje me rolin e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si institucion i pavarur dhe autoriteti përgjegjës që mbikëqyr dhe monitoron të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale në përputhje me ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar gjatë periudhës janar-dhjetor 2018.

2. Informacion në lidhje me kontrollet dhe hetimet administrative lidhur me respektimin e të drejtës së informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale, hetimet proaktive me iniciativë lidhur me procesin e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave personale të qytetarëve nga kompanitë e mëdha publike dhe private.

3. Masat administrative për shkeljet ligjore të konstatuara për mungesën e programeve të transparencës, regjistrin të kërkesave e përgjigjeve dhe caktimin e koordinatorit, me fokus të veçantë ministritë dhe organet e pushtetit qendror.

4. Informacion i përgjithshëm për ankesat me objekt të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

5. Angazhimin e institucionit të Komisionerit për pasurimin e programeve të transparencës së institucioneve publike dhe jopublike me informacionet që kanë të bëjnë me

objektivat për zhvillimin e qëndrueshëm, në kuadër edhe të rezolutës së Kuvendit të dhjetorit 2017 “Për objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm të Axhendës 2030 të shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara”.

6. it të Popullit për vendet vakante në tri seksionet e këtij institucioni.
(komision përgjegjës)

Marrin pjesë: Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Bledar Çuçi, Edmond Leka, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Elena Xhina dhe Xhemal Qefalia.

Mungojnë:

Enkelejd Alibeaj, Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi, Nasip Naço, Astrit Veliaj, Fatmir Mediu, Spartak Braho, Tom Doshi, Fatmir Xhafaj

Të ftuar:

Besnik Dervishi

HAPET MBLEDHJA

Ulsi Manja – Përsëndetje!

Sot jemi mbledhur për të marrë informacion në lidhje me rolin e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si institucion i pavarur dhe autoriteti përgjegjës, që mbikëqyr dhe monitoron të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale në përputhje me ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, direktivat proaktive lidhur me procesin e mbledhjes dhe përpunimin e të dhënave personale të qytetarëve nga kompanitë e mëdha publike dhe private.

Po ashtu jemi shumë të interesuar për masat administrative, për shkeljet ligjore të konstatuara, për mungesën e problemeve të transparencës së regjistrit të kërkesave e përgjigjeve dhe caktimin e koordinatorit, me fokus të veçantë ministritë dhe organet e pushtetit qendror

Gjithashtu, për kolegët e mi do të ishte me shumë interes një informacion i përgjithshëm për ankesat, me objekt të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe angazhimi i institucionit të Komisionerit për pasurimin e programeve të transparencës së institucioneve publike dhe jopublike, me informacione që kanë të bëjnë me objektivat për zhvillimin e qëndrueshëm, në kuadër dhe të rezolutës së Kuvendit të dhjetorit 2017 “Për objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm të Axsendës 2030 të shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara”. Besoj se është i mjaftueshëm një informacion i tillë. Kjo do të na shërbejë edhe ne, si Komision i Ligjeve të Kuvendit, për të krijuar një imazh të punës së komisionerit.

Edhe një herë, shumë faleminderit për mirëpritjen dhe fjalën po jua kaloj juve!

Besnik Dervishi – Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Është një privilegj për mua t’ju pres në këtë takim pranë mjediseve të punës së institucionit të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Uroj dhe shpresoj që ky mos të jetë takimi ynë i parë dhe i fundit, por të jetë një praktikë, që do të konsolidohet nga Komisioni i Ligjeve, në bashkëpunim me të gjitha institucionet e tjera të pavarura, që janë nën monitorimin e Komisionit të Ligjeve.

Paraprakisht, ky institucion funksionon dhe besoj se funksionon në parametra të pëlqyeshme edhe falë ndihmës suaj dhe mbështetjes që përfaqësuesve të Komisionit të Ligjeve që i ka dhënë këtij institucioni. Ashtu siç dihet, veprimtaria kryesore e Zyrës së Komisionerit mbështetet në dy shtylla kryesore, në dy të drejta dhe liri themelore: e drejta për informim dhe e drejta e mbrojtjes e të dhënave personale.

Veprimtaria e Zyrës së Komisionerit rregullohet me ligjin nr. 9857 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i cili siç dihet është në funksion të nenit 35 të Kushtetutës, që përcakton garantimin e të drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale. Kemi pasur edhe një ligj të mëparshëm që është ligji nr. 8517 i miratuar në vitin 1999, por me ligj ishte parashikuar funksionimi i Zyrës së Komisionerit. Funksionimi i Zyrës së Komisionerit ka ardhur si detyrim i nënshkrimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit nëpërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian, për arsye se në standardet e Bashkimit Europian kërkohet që vendet e Bashkimit Europian, mbrojtjen e të dhënave personale ta garantojnë nëpërmjet një institucioni të pavarur.

Gjithashtu, ligji ka pësuar edhe përmirësimet e tij. Në vitin 2012 është bërë një amendim thelbësor i ligjit, në fund të fundit, ka qenë transpozim i plotë i direktivës nr. 2546, që është direktiva në bazë të së cilës ka qenë e rregulluar mbrojtja e të dhënave personale në Bashkimin Europian. Kjo deri në 25 maj të këtij viti, sepse nga 25 maj i vitit 2018 ka hyrë në fuqi Rregullorja e re përgjithshme e Bashkimit Europian, të cilën do t’i bëjmë një shpjegim të shkurtër pak më poshtë...

Gjithashtu, pjesa tjetër e Zyrës së Komisionerit është e drejta për informim, që buron nga neni 23 i Kushtetutës. Ne kemi pasur një zhvillim në ligjin nr. 8399 “Për të drejtën e informimit mbi dokumentet zyrtare”. Natyrisht, nuk është se ka qenë një ligj i keq, por, për shkak të instrumenteve që parashikonte ky ligj nuk ishte aq delikat dhe jo më kot në renditjen botërore zinte vendin e 86-të. Me miratimin e ligjit të ri “Për të drejtën e informimit”, është bërë një hov cilësor për sa i përket legjislacionit, sepse aktualisht ky ligj renditet në vendin e 6 në botë.

Gjithashtu, është përcaktuar edhe një institucion, që e monitoron në mënyrë të drejtpërdrejtë zbatimin e së drejtës së informimit nga ana e një institucioni të pavarur. Pra, për veç kompetencave të mbrojtjes së të dhënave personale, ashtu siç duket edhe nga emërtimi, Zyrës së Komisionerit iu ngarkua edhe kjo e drejtë.

Ky ligj sjell disa risi, më e rëndësishmja është se përcaktohen një person i dedikuar çdo autoriteti publik, pra në çdo institucion, në të gjitha nivelet e institucioneve, që nga ato të nivelit më të lartë deri në institucionet e varësisë. Ka disa rregulla shumë të qarta për sa i

përket procedurës. Vendoset një afat 10-ditor për kthimin e përgjigjes nga autoriteti publik kur më parë e kishim 40 ditë dhe pas 40 ditësh ndodhte shpesh që humbiste autoriteti.

Pa u ndaluar në shumë detaje, dua të them dy gjëra thelbësore: njëra është instrumenti i programit të transparencës, që është informacioni që bëhet publik pa kërkesë nga ana e autoriteteve publike, pra nga ana e të gjitha institucioneve. Në nenin 7 të ligjit janë parashikuar të gjitha kategoritë, që nga disa gjëra që duhek modeste, pra që nga të dhënat për institucionin, punonjësit e institucionit, drejtuesit, CV-të e drejtuesve dhe deri te kontratat, prokurimet dhe raportet e auditimit të brendshëm apo të Kontrollit të Lartë Shtetit për çdo institucion, pra që duhet të jenë publike pa kërkesë. Pra, duhet të jenë të publikuara në programin e transparencës.

Një tjetër risi e veçantë është që moszbatimi i procedurës dhe i afateve sjell për personat përgjegjës, kryesisht për koordinatorët, edhe sanksione administrative, që duhet thënë nuk janë të nivelit modest.

Përveç këtyre dy kolonave kryesore, Zyra e Komisionerit ka edhe disa kompetenca, që burojnë nga ligje të tjera. Një kompetencë buron nga ligji nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe të konsultimin publik”, që ka të bëjë me shqyrtimin e ankesave të shtetasve kur nga autoritetet publike janë shkelur procedurat për njoftimin dhe konsultimin publik të akteve normative, që ata paraqesin në Kuvend për miratim.

Gjithashtu, ka të paktën dy detyrime për Zyrën e Komisioneri, kryesisht për monitorimin e Policisë së Shtetit, por edhe të kontrollorëve, siç quhen ata që përpunojnë të dhëna personale dhe janë objekt i ligjit “Për masat shtesë të sigurisë publike”.

Gjithashtu, ka detyra të veçanta për zbatimin e ligjit “Për kontrollin kufitar”, veçanërisht për mbarrëvajtjen e sistemit të tij, edhe për ligjin “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, ku ne kemi një bashkëpunim me institucionin e ILDKPI-së pikërisht për të koordinuar garancinë si të sinjalizuesve, edhe të mbrojtjes së të dhënave personale për të gjithë personat e tjerë që janë objekt i këtij ligji.

Detyra shumë të rëndësishme ka veçanërisht për ligjin “Për masat shtesë të sigurisë publike”. Besoj se ju e mbani mend, sepse keni qenë dëshmitar, ka pasur një debat shumë të madh publik për miratimin e këtij ligji edhe në Komisionin e Ligjeve. Kjo është një nga arsyet që Komisionerit i është dhënë një rol tejet i rëndësishëm për të garantuar mbrojtjen e të dhënave personale të shtetasve, si një e drejtë kushtetuese e tyre.

Gjithashtu, kemi edhe disa detyra të tjera, që shpeshherë rëndom, pavarësisht se jemi një institucion i pavarur, që na takon ne me vendim qeverie...*(nuk kuptohet)*. Megjithatë, ne u jemi përgjigjur, jemi pjesë e strategjisë ndërsektoriale për reformën në administratën publike,

pra jemi përgjegjës për indikatorin nr. 11. Transparencën e autoriteteve publike”, jemi pjesë e strategjisë kombëtare antikorruption, si një nga institucionet e integritetit, jemi pjesë e strategjisë së drejtësisë për të mitur dhe pjesë e axhendës kombëtare për të drejtat e individëve.

E fundit që është shtuar në kompetencat e Zyrës së Komisionerit është një detyrim që buron nga marrëveshja që nënshkroi qeveria shqiptare me *Eurojust-in*, ku nga 25 nene që ka marrëveshja, 10 u përkasin detyrave që ka Zyra e Komisionerit për fushën e mbrojtjes së të dhënave personale në këtë marrëveshje, ku çdo vit oficeri i mbrojtjes së të dhënave i *Eurojust-it* me Zyrën e Komisionerit janë të detyruar që të paraqesin raportin vjetor të kësaj marrëveshjeje përpara Komisionit European.

Kjo është struktura e Zyrës së Komisionerit. Natyrisht, falë edhe kontributit tuaj, Zyra e Komisionerit këto vitet e fundit është forcuar edhe në numër, mbase jo në atë numër që ne kemi rënë dakord së bashku. Natyrisht, duhet të forcohet ende, kjo është një detyrë e lënë edhe nga partnerët tanë ndërkombëtarë për forcimin e Zyrës së Komisionerit, veçanërisht në funksion të zhvillimeve të reja, qoftë në fushën e së drejtës së informimit, por veçanërisht në zbatimin dhe implementimin e Rregullores së re të përgjithshme të Bashkimit European. Këto janë kompetencat e Zyrës së Komisionerit në fushën e mbrojtjes së të Dhënave Personale, natyrisht nuk po i lexoj për të mos harxhuar kohë dhe të ndalemi në pjesën që është më e rëndësishme.

Gjithashtu, ligji i jep të drejtë Komisionerit të nxjerrë akte nënligjore për të rregulluar sektorë të veçantë. Ne kemi rreth 20 akte nënligjore që plotësojnë fushën e veprimtarisë së Komisionerit për sa i përket dhe mbrojtjes së të dhënave personale, sepse për sa i përket të drejtës për informim, ligji nuk ia ka dhënë këtë të drejtë Komisionerit për të dalë me hartë ligjore, ndoshta mund të jetë një risi ose një shtesë, që natyrisht do ta diskutojmë së bashku në amendimet që do të paraqesim së shpejti në Komisionin e Ligjeve për të bërë disa përmirësime në ligjin “Për të drejtën e informimit”, por aty janë disa nga sektorët kryesorë. Duhet thënë se mbrojtja së të dhënave personale shtrihet në të gjithë veprimtarinë, që nga sistemi i vidiosurvejimit, në fushën e arsimit, shëndetësor dhe janë përmendur sektorët kryesorë në të cilët të dhënat nuk janë vetëm të dhëna personale, por konsiderohen një shkallë akoma më lart... media vizive, media e shkruar, sistemi gjyqësor, sistemi bankar, si dhe për qëllime të fushatës zgjedhore.

Gjithashtu, kemi edhe disa vendime të Komisionerit, ku njëri prej tyre është kthyer mbrapsht, pra është përcaktimi i shteteve me nivel të mjaftueshëm për mbrojtjen e të

dhënave personale, sepse shumë të dhëna personale ilustronjë edhe transferim ndërkombëtar, por, natyrisht ne zbatojmë me përpikëri rregullat dhe standardet e Bashkimit Europian.

Një tjetër praktikë që kemi ndjekur në mbrojtjen e të dhënave personale janë edhe rekomandimet unifikuese. Kemi marrë sektorë të veçantë dhe jemi përqendruar në këta sektorë të veçantë, duke shqyrtuar ankesat nga vijnë në këta sektorë, por edhe duke kryer hetime. Për shembull, ne kemi marrë sektorin bankar, kemi inspektuar të gjitha bankat e nivelit të dytë. Në funksion të inspektimit dhe të problematikave që kanë dalë, ne kemi dalë me një rekomandim unifikues, që ka analizuar të gjitha problematikat e dala në sektorin bankar dhe e kemi çuar në të gjitha bankat e nivelit të dytë, ndërkohë **(nuk kuptohet)** të Bankës së Shqipërisë. Në rastin konkret duhet thënë se Banka e Shqipërisë ka ndërhyrë duke ndryshuar rregulloren e saj, në funksion të rekomandimeve që ne kemi bërë. E njëjta gjë që ka në sistemin **(nuk kuptohet)**, në shëndetësi, në arsim.

Së fundi, ne jemi ndalur në sektorin e turizmit, duke qenë se është një nga sektorët me shumë përparësi për sa i përket zhvillimit ekonomik, veçanërisht tek organet e vetëqeverisjes vendore, sepse këtë e kemi lidhur jo vetëm me mbrojtjen e të dhënave personale, por edhe me transparencën. Do ta shikojmë më pas që kemi bërë edhe programin model të transparencës për organet e vetëqeverisjes vendore, sepse janë organe, të cilat ofrojnë shërbime më afër qytetarit se të gjitha autoritetet e tjera publike.

Natyrisht, për sa i përket të drejtës së informimit kemi një **(nuk kuptohet)** për sa u përket ankesave në vite. Siç shikohet që në vitin 2014, kur ligji hyri në fuqi, në muajin nëntor ishin **26** ankesa, në vitin 2015 ishin 274, pastaj kemi një rritje më vonë, kurse në vitin 2017 ka pasur një rënie 560 ankesa, por kjo ka ardhur, sepse në vitin 2016 kemi pasur shumë projekte të shoqërisë civile dhe ankesat kanë qenë rreth 60% të shoqërisë dhe 40% të qytetarëve. Në vitin 2017 kemi pasur një ndryshim, ku dominonin ankesat e drejtuara nga qytetarët. Ndërsa këtë vit kemi një shtim të numrit të ankesave. Deri në fund të muajit nëntor nga Zyra e Komisionerit janë regjistruar gjithsej 745 ankesa. Kjo ka të bëjë edhe më një lloj problematike që ka filluar të vihet re gjatë muajve të fundit në autoritetet publike, ku jo çdo gjë ka funksionuar siç duhet, në anën tjetër vihet re edhe një ndërgjegjësim i qytetarëve, të cilët nuk kërkojnë “mikun” për të marrë një informacion, por ndjekin rrugën ligjore dhe procedurën e caktuar në ligj, sepse, me sa duket, është krijuar bindja që e zgjidhin më mirë, më drejt dhe më shpejt duke ndjekur procedurën ligjore.

Edhe mbrojtja e të dhënave personale ka pasur një rritje, natyrisht, në numër janë më të reduktuara, sepse kuptohet që është një fushë më e vështirë për t’u kuptuar dhe lidhet me disa aspekte. Mbrojtja e të dhënave personale deri më vonë është konsideruar një luks.

Tashmë është shndërruar në nevojë edhe për shkak **(nuk kuptohet)**. Pra, nga viti 2014 që janë administruar gjithsej 73 ankesa, tani kemi arritur në nivelin e mbi 200 ankesave, të cilat janë administruar vitin e kaluar.

Një nga fushat kryesore të veprimtarisë së Zyrës së Komisionerit është sensibilizimi. Natyrisht, ne nuk kemi degë rajonale, por strukturat e Zyrës së Komisionerit kanë qenë gati prezente në të gjithë territorin e vendit. Ne kemi zhvilluar disa aktivitete sensibilizuese. Dy nga më të rëndësishmit kanë qenë: njëri është që ne i kemi shkelur të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore, ku janë organizuar trajnime dhe bashkëbisedime, duke ftuar të gjitha organet e vetëqeverisjes vendore dhe të gjitha drejtoritë rajonale në nivel qarku. Besoj se këto takime kanë qenë frytdhënëse edhe për shkak të impaktit që kemi verifikuar më pas në këto institucione nëpërmjet monitorimit të vazhdueshëm që bëjmë.

Një aktivitet tjetër i rëndësishëm i zyrës ka qenë ai që kemi zhvilluar me shkollat në të gjithë territorin e vendit, ku kemi qenë prezentë në të gjitha ish-rrethet. Mund të kemi shkelur gati të gjitha gjimnazet e vendit, por edhe mbi 100 shkolla 9-vjeçare për të bërë trajnime me nxënësit se si ata të kuptojnë se t'i mbrojnë të dhënat personale në raport me rrjetet sociale. Për këtë ne kemi bërë edhe një studim, të cilin ia kemi vënë në dispozicion edhe Ministrisë së Arsimit, duke i kërkuar që e drejta për informim, veçanërisht mbrojtja e të dhënave personale të vendoset në kurrikulat mësimore. Gjithashtu, Zyra e Komisionerit ishte prezente me një leksion në Shollën e Magjistraturës dhe të Administratës Publike. Këtë vit ishte për të drejtën e informimit, vitin tjetër do të jetë prezente edhe me mbrojtjen e të dhënave personale. Duhet thënë se në një formular, që ka shpërndarë Shkolla e Administratës Publike, mbrojtja e të dhënave personale ka qenë një nga temat më të kërkuara për shkak të sensibilizimit të madh që i është bërë dhe hyrjes në fuqi të rregullores për të dhënat.

Mua më vjen mirë të prezantoj, e kemi edhe në kartolinën e urimit të Vitit të Ri, që Zyra e Komisionerit në konferencën e 40-të botërore të autoriteteve të mbrojtjes së të dhënave personale u nderua me çmimin e parë për realizimin e projektit, të cilin e bëmë së bashku me ish-ministren e Inovacionit dhe Administratës Publike dhe me Postën Shqiptare për krijimin e një pulle postare që simbolizon mbrojtjen e të dhënave personale **(nuk kuptohet)**.

Më duhet të them se Zyra e Komisionerit është e integruar në të gjithë organizmat ndërkombëtarë që nga Forumi i Këshillit të Europës dhe në të gjitha ka qenë një risi mbrojtja e të dhënave personale. Këto forume botërore kanë edhe forumet e tyre teknike, ku një herë ose dy herë në vit ekspertët e të gjitha autoriteteve paraqesin rastet e veçanta, ose rastet më të mira të hasura gjatë eksperiencës së tyre dhe ky është një shkëmbim eksperiencë që i

ndihmon të gjitha autoritetet për të realizuar objektivat e punës së tyre dhe për të unifikuar praktikatat e tyre në nivel evropian e më gjerë.

Gjithashtu, kemi nënshkruar disa marrëveshje bashkëpunimi më të gjitha vendet e rajonit, por më e rëndësishmja është një marrëveshje që kemi nënshkruar me autoritetin italian, që është një nga vendet kryesore të BE-së, por që lidhet shumë ngushtë me marrëdhëniet që ka shteti shqiptar me shtetin italian, ose ekonomia shqiptare me atë italiane, e cila na ka ndihmuar shumë për të gjithë operatorët ekonomikë, kryesisht në sektorin e *call center*-ve, sepse kjo marrëveshje i zbuti shumë efektet e ligjit të ri që bëri qeveria italiane, e cila kufizonte përdorimin e të dhënave personave...

(Diskutime pa mikrofoni)

Për shkak të kësaj marrëveshjeje nuk pati penalizime për operatorët, të cilët e zhvillonin aktivitetin e tyre në territorin shqiptar. Besoj se, siç jeni në dijeni, ligji italian nuk solli ndonjë efekt të madh për sa i përket mbylljes së *call center*-ve në Shqipëri. Duhet thënë se tek ato *call center*-a, të cilat ishin serioze dhe që punonin konform ligjit, nuk pati asnjë efekt.

Prioriteti kryesor i punës së Komisionerit, ashtu sikurse edhe ju jeni në dijeni, është organizimi i konferencës së 41 ndërkombëtare **(nuk kuptohet)** dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

Duhet thënë se kjo konferencë do të zhvillohet në dy sesione: sesi i mbyllur, ku marrin pjesën vetëm autoritetet. Bëhet fjalë për 140 autoritete nga e gjithë bota. Pjesa tjetër që është e përmasave shumë të mëdha, që është sesi i hapur, ku marrin pjesë të gjithë ekspertët e mbrojtjes së të dhënave personale, studiuesit, universitetet dhe parashikohet që pjesëmarrja të jetë e madhe. Të paktën dy herët e fundit që është zhvilluara në Hong Kong dhe në Bruksel kanë qenë mbi 1200 pjesëmarrës. Ndoshta është një peshë më e madhe sa mund të mbajnë shpatullat tona, por mendoj se është e rëndësishme që të paktën ta provojmë dhe pastaj me ndihmën e Kuvendit, të qeverisë dhe të gjitha institucionet e tjera do t'i dalim në krye.

(Nuk kuptohet) E drejta për të organizuar konferencën fitohet, sepse janë të ftuara të aplikojnë të gjitha shtetet.

(Ndërhyrje pa mikrofoni)

Konferenca do të zhvillohet në tetor të vitit 2019. Bëhet me konkurrim. Ne konkurruam edhe dy vjet më parë. Dolëm në finale me Marokun, por për arsye gjeografike u zhvillua në Marok, sepse zhvillohet një herë në Europë, një herë në kontinentin Amerikan, një herë në Azi dhe në Afrikë. Natyrisht, ishte Maroku duke qenë se konferenca e mëparshme

ishite zhvilluar në Amsterdam. Ne aplikuam përsëri dhe u vlerësuam si fituese. Ky është një event shumë i rëndësishëm jo vetëm për fushën e privatësisë, por mendoj se është një nga reklamat më pozitive që mund t'i bëhet vendit tonë qoftë në fushën e zhvillimit ekonomik, të turizmit, por edhe të kapaciteteve që kaq ky vend për të garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

(Nuk kuptohet) nuk e di sa do të jem i bezdisur në këtë pikë, por uroj që jo. Në *slide-in* e fundit do të shikoni objektivat e Zyrës së Komisionerit, të cilat jua kam përmendur edhe më parë. Këto janë aktet kryesore, mbi të cilat mbështet veprimtaria e Zyrës së Komisionerit. Ne kemi bërë disa analiza dhe kemi filluar të përgatitim aktet. Disa prej tyre i kemi gati, disa të tjera nuk varen nga ne, por për realizmin e tyre kërkohet kontributi i ministrive përkatëse, siç është kontributi i Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme, veçanërisht i Ministrisë së Drejtësisë. Do të kërkoj shumë shkurtimisht kortezinë tuaj që t'ju jap mundësinë bashkëpunëtorëve të mi që të bëjnë një prezantim për secilin nga aktet.

Specialiste – Shkurtimisht kemi përgatitur një prezantim të shkurtër në lidhje me ndryshimet e ligjit për të drejtën e informimit.

Qëllimi i këtij projektligji sjell përmirësime të nevojshme, të dobishme dhe të rëndësishme në lidhje me garantimin e kësaj të drejte kushtetuese në Republikën e Shqipërisë.

Pavarësisht se ligji aktual është cilësuar si një nga ligjet më të mira në vend, në këta katër vjet janë evidentuar disa problematika. Në këtë drejtim Zyra e Komisionerit, pas konsultimeve edhe me ekspertë ndërkombëtare dhe me aktorë të shoqërisë civile, i ka pasqyruar ato në projektligj, me qëllim përmirësimin e tij.

Disa nga problematikat janë: nevoja për t'i pasur vendimet e Komisionerit tituj ekzekutivë, si dhe parashikimin e sanksioneve për autoritetet publike, në rast të moszbatimit të vendimit të Komisionerit, pasi ka pasur mjaft raste në praktikë kur vendimet e Komisionerit nuk janë zbatuar dhe është shumë i domosdoshëm ky ndryshim ligjor.

Së dyti, qartësimi i detyrimit të drejtuesve të autoriteteve publike për emërimin e koordinatorit të të drejtës për informim, si dhe forcimin e rolit të tij.

(Nuk kuptohet)

Specialiste – Vendosja e sanksioneve jo vetëm ndaj koordinatorit, por edhe ndaj personave përgjegjës, pasi në praktikë kanë ndodhur raste që informacioni ndodhet te struktura përgjegjëse dhe ligji aktual sanksionon koordinatorin, ndërkohë që është munduar në praktikë të sanksionojë personat përgjegjës, por... Të drejtat e komisionerit për t'u

përfshirë në procesin e klasifikimit informacionit sekret shtetëror, pra të bëjë një testim në themel të çështjes...

Gjithashtu, kufizimin e zbatimit të ligjit për të drejtën e informimit vetëm në sferën administrative të gjyqësorit dhe prokurorisë, pasi ne e dimë që këto veprojnë në bazë të ligjit procedural. Kjo mendohet të rregullohet me këto ndryshime.

Gjithashtu, është edhe krijimi i bordit këshillimor për të zgjedhur komisionerin, për vlerësim më të mirë të çështjeve

Specialiste— Këto kanë ardhur si rezultat i praktikës.

Së pari, ne kemi bashkëpunim shumë të ngushtë me shoqërinë civile dhe kjo na është kërkuar nga shoqëria civile, por edhe nga universitetet, kontributin e të cilave e kemi kërkuar shpeshherë për çështje të veçanta. Faktikisht ka funksionuar një lloj bordi, por i painstitucionalizuar, ndoshta ka ardhur momenti ta institucionalizojmë këtë bord këshillimor pranë zyrës së komisionerit.

(Nuk kuptohet) ...pra mendojmë se duhet të unifikohet edhe për efekt të zbatueshmërisë së tyre.

Klotilda Bushka – Ashtu sikurse e thatë, tashmë është rritur edhe ndjeshmëria publike ndaj të dhënave personale, që tregon edhe një performancë në rritje të punës së këtij institucioni, sepse sado që qytetarët ndërgjegjësohen, janë mekanizma institucionale dhe ligjore ato që në një farë mënyre rrisin edhe përdorimin nga publiku të të drejtave që parashikon legjislatura për mbrojtjen e këtyre të drejtave.

Unë kam dy çështje, që mendoj se janë të rëndësishme. E preku pak parafolësja, fatin e të dhënave personale për sa i përket procesit gjyqësor. Mua më shqetëson fakti sepse deri para pak kohësh të gjitha vendimet e gjykatave kanë qenë publike me emra palësh dhe kanë qenë të përcaktuara qartë, heqim rastet kur bëhej fjalë për të mitur, që ishin çështje sensitive, ndërsa sot kemi një problem me të gjithë praktikantët e ligjit, sepse nuk mund të gjejnë dot dhe të referojnë në praktikat që ndjekin vendimet e mëparshme të gjykatave, të cilat mund të jenë shprehur për të njëjtin rast, sepse nuk i gjejnë dot më duke mos i pasur emrat e palëve. Një nga elementet e kërkimit që bëjnë juristët sot janë palët, sepse çështjet në praktika gjyqësore mbahen mend me emra palësh, ku avokatët dhe gjyqtarët për t'iu referuar në punë e tyre praktikës gjyqësore, u referohen emrave të palëve dhe nuk mund të mbajnë mend me objekt, sepse mund të jetë i njëjtë për një mijë çështje, ndërsa pala është një për një çështje. Unë e shoh që ligji juaj nuk e ndan sferën e përgjegjësisë, por kjo duhet adresuar te ndryshimet që do të na paraqisni.

Dje, gjatë shqyrtimit të ligjit për noterinë, vumë re një propozim që, kur të dhënat gjatë një procedimi administrativ mungojnë, vetë organi mund t'i kërkojë gjykatës të lëshojë një autorizim, në mënyrë që gjykata të vendosë dhënien e këtyre të dhënave. Unë nuk e njoh këtë mekanizëm që të jetë i parashikuar në ndonjë ligj dhe ne nuk e pranuam, e kemi hedhur poshtë atë nën të ligji i noterisë...

Vasilika Hysi – Ishte për tabulatet, për bisedat telefonike.

Klotilda Bushka – Pavarësisht faktit se çfarë kërkoje, ideja ishte që aty flitej për të dhënat personale dhe sensitive. Dua të di nëse e keni hasur këtë si procedurë në punën tuaj të përditshme, a është e parashikuar në ndonjë ligj dhe, nëse po, a duhet ta konsiderojmë këtë në kuadër të të drejtave të njeriut? Në fakt, ne i ngatërrojmë konceptet midis të drejtës civile, administrative dhe penale, pasi llojet e garancive të detyrimeve në të tria fushat janë të ndryshme. Nuk duhet të harrojmë që Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut i ka të ndara këto garanci. Pra, nga dëshira për të qenë të zellshëm për zgjidhjen e çështjeve praktike, mos ndoshta ne po cenojmë këto standarde, për të cilat vendet e zhvilluara dhe standardet ndërkombëtare tashmë i kanë konsoliduar qëndrimet përkatëse?

Vasilika Hysi – Shumë faleminderit për prezantimin dhe mikpritjen!

Nisur edhe nga disa ankesa që janë paraqitur, unë kam dy pyetje.

Pyetja e parë lidhet me të dhënat personale, të cilat, në kuadër të të drejtës së informimit, çdo qytetar i kërkon pa pasur nevojë të japë argumente pse i duhen. Problemi ka lindur me zyrat e gjendjes civile, të cila kërkojnë dokumente të **(nuk kuptohet)** dhe, nga ana tjetër, në dijeninë time, nëse e kam informacion të saktë, Komisioneri, zyra juaj ka lëshuar një rekomandim që të dhënat nuk mund të jepen pa pasur autorizim, një prokurë për dhënien e tyre. A keni gjetur ndonjë përplasje midis ligjit të gjendjes civile, konkretisht nenit 3, dhe standardeve që ju keni në punën tuaj dhe në direktivën e re të Bashkimit European?

Pyetja e dytë lidhet angazhimin tuaj në kuadër të reformës të drejtësisë të të miturve, ku unë dua t'ju falënderoj për të gjithë kontributin që keni dhënë gjatë reformës në drejtësi dhe përmirësimin e ligjeve nga këndvështrimi i të drejtave të njeriut, ku komisioni ynë ka qenë shumë i kujdesshëm që sa herë ka pasur nene apo çështje, siç ishte çështja që ngriti zonja Bushka, që lidhen me të drejtat personale, jemi treguar shumë të rezervuar dhe kemi preferuar ta heqim, pasi nuk kemi pasur opinion nga zyra juaj. Në këtë kuadër, dua të di se cila është problematika që keni hasur në zbatimin e reformës së drejtësisë për të mitur lidhur mbrojtjen e të dhënave personale? E them këtë, sepse para një jave ne kemi pasur një seancë dëgjimore me ministren e Drejtësisë, e cila bëri një prezantim shumë të mirë të të gjitha

problematikave dhe të hapave që kishte hedhur, por njëkohësisht kërkoi edhe ndihmën e Kuvendit të Shqipërisë në këtë proces.

Çështja e tretë që dua të theksoj, më ka shqetësuar është një aspekt i ri, të cilin e përmendi Komisioneri, të dhënat personale dhe rrjetet sociale. Besoj se të gjithë ju e dini që ka një debat shumë të madh lidhur me këtë. Ne nuk flasim, sepse jemi persona publikë dhe jemi shumë të atakueshëm në rrjetet sociale, por besoj se Shqipëria duhet të jetë në atë standard që minimumi menaxhuesit e rrjeteve sociale, mediat online, gazetat që kanë blogje e të tjerë duhet të kenë rregulla specifike për marrjen e një ankese, për nxjerrjen e të dhënave sensitive, nuk them vetëm për fyerje dhe shpifje, sepse është raporti i të drejtës për informim, por për të rivendosur një të drejtë të shkelur, duke bërë veterregullim pa qenë nevoja që t'i drejtohem gjithmonë Kodit të Procedurës Civile apo Kodit Penal. A e keni në objektivin tuaj mbrojtjen e të dhënave personale dhe cila do të ishte kërkesa në raport me angazhimin e Kuvendit, pse jo edhe të qeverisë në këtë proces?

Faleminderit!

Specialiste- Së pari ju falënderojmë për mikpritjen dhe për shpjegimet që na dhatë për veprimtarinë e institucionit.

Unë kam dy pyetje që kanë të bëjnë me marrëdhëniet me qytetarët. Sa ankesa keni pasur nga qytetarët gjatë viti 2018 dhe sa nga këto jeni munduar t'i zgjidhni?

Si është marrëdhënia juaj institucionale me institucionet dhe administratën shtetërore? A ju përgjigjen në kohë dhe në afate kur ju kërkoni informacion? Nëse jo, çfarë masash merrni ju kundrejt administratës shtetërore për zgjidhjen e problemit?

Faleminderit!

Specialiste - Çështja që lidhet me vendimet gjyqësore, ajo që në gjuhën tonë quhet udhëzimi i të dhënave personale, një nga aktet nënligjore të Komisionerit është vendimi numër 15, që rregullon analizimin e të dhënave personale në sistemin gjyqësor. Ky është realizuar në vitet para të funksionimit të zyrës së Komisionerit, me ndihmën e projektit të Bashkimit Europian, që ka asistuar në ngritjen e këtij institucioni. Natyrisht, ngeli i pazbatuar deri në vitin 2016, për arsye se ministri i Drejtësisë duhej të nxirrte një udhëzim për të bërë zbatueshëm udhëzimin e Komisionerit, pasi sistemet ku publikohen vendimet e gjykatave administrohen nga Ministria e Drejtësisë dhe, për hir të së vërtetës, në të gjitha diskutimet ndërkombëtare që ne kemi bërë ky konsiderohet handikap, sepse mendohej se cenohej pavarësia e sistemit gjyqësor, i cili duhet të vetadministrohet nga gjykatat dhe jo nga ekzekutivi, siç është Ministria e Drejtësisë, për këtë ka sjellë edhe këtë ngërç.

Në vitet 2013, 2014 dhe 2015, në progresraportin e Bashkimit European harmonizimi i të dhënave personale ka qenë si një detyrim që duhej zbatohet dhe, më në fund, në vitin 2016 kjo është realizuar, ku edhe ne kemi asistuar me Ministrinë e Drejtësisë në nxjerrjen e këtij udhëzimi. Në fillim të zbatimit të projektit kemi pasur biseda informuese edhe me drejtuesit e Dhomës Kombëtare të Avokatisë. Kjo nuk ka të bëjë me harmonizimin e të dhënave personale nga zyra e Komisionerit, por ka të bëjë me mënyrën sesi përcaktohet procedura nga ana e Ministrisë së Drejtësisë, ku ndoshta duhet ndërhyrë për të krijuar lehtësira ndaj avokatëve ose operatorëve të tjerë të sistemit, të cilët janë të interesuar për vendimet e tyre gjyqësore.

Unë nuk jam në gjendje që t'ju jap detaje, sepse kjo lidhet më tepër me mënyrën e administrimit të sistemit nga vetë gjykatat ose Ministria e Drejtësisë. Në rastet që ne kemi pasur dy ose tri ankesa të tilla, në këndvështrimin e mbrojtjes të të dhënave personale nuk ka pasur pengesë. Kuptohet, ato që hidhen në sistem *online*, futen kontaktet e kërkimit, ku nuk mundet që të dhënat personale, të jenë të paharmonizuara, sepse kjo lidhet edhe me një nga konceptet e reja, të miratuara në rregulloren e re të përgjithshme të Bashkimit European edhe me të drejtën për t'u ... Një vendim gjyqësor ku vendet e ... janë palë nuk mund të rrijë pafundësisht në sistemet e kërkimit.

(Inçizim i dobët)

Në këtë këndvështrim, ato që hidhen në motorët e kërkimit duhet të jenë të harmonizuara. Ndërsa vetë sistemi i gjykatës nuk ka pse të penalizojë dhe të mos ua vërë në dispozicion avokatëve, të cilët, për arsye të punës së tyre, duhet të bëjnë kërkime në këtë sistem. Pra, është diçka që lidhet me Ministrinë e Drejtësisë që aktualisht administron sisteme, të cilat, për mendimin tonë modest, duhet t'i kalojnë vetë gjykatave në administrim dhe të mos jenë më nga ministria e Drejtësisë, sepse edhe ne e kemi më kollaj, por edhe avokati, edhe qytetarët e kanë më kollaj të drejtohen në gjykatë për të zgjidhur një problem, sesa për të bërë një ndërhyrje ose një rregullim... Për shembull, ne kemi pasur shumë ankesa për autorizimin e të dhënave personale të qytetarëve. Gjykatat nuk kanë qenë në gjendje ta realizojnë, sepse nuk e administrojnë vetë sistemin, por duhet që t'ia dërgojnë administratorit që është në Ministrinë e Drejtësisë.

Lidhur me aksesin tek të dhënat, dihet se shumë nga institucionet shtetërore administrojnë baza të dhënash edhe për të drejtën e aksesit që mund të ketë. Ne jemi ndalur gjatë me sistemin **TIM**. Kemi bërë një verifikim të tij në vitin 2016 dhe kemi në plan të bëjmë një riveifikim të tij, mundësisht në tremujorin e parë të vitit 2019, sepse kemi konstatuar që qoftë në ligje të tjera, qoftë në marrëveshje bashkëpunimi, të nënshkruara nga

Policia e Shtetit, nuk kuptohet më kush e ka të drejtën e aksesit në këtë sistem. E njëjta gjë po ndodh me të gjitha bazat e të dhënave. Ne jemi në bashkëpunim të ngushtë edhe me AKSHI-n dhe po përpiqemi të vendosim, si të thuash, filtra të fortë për mbrojtjen e të dhënave personale.

Nga njëra anë, besoj se të gjithë jemi të njohur me projektet e reja, që ishin në fushën e arsimit ose në fushën e shëndetësisë. Marrim rastin e arsimit, që u përdor edhe medietikisht. Iniciativa e Ministrisë së Arsimit ishte shumë pozitive. Unë nuk besoj se ka ndonjë prind në botë që nuk dëshiron të ketë informacion online nëpërmjet një *app*-i për ecurinë e fëmijës në shkollë në kohë reale, por mënyra si u kërkua të realizohej nuk ishte në bazë të ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, sepse nuk kishte një ligj, siç thotë Kushtetuta, ku të dhënat personale përpunohen ose me pëlqimin e vetë shteteve, ose me ligj. Pra, nuk kishte asnjë ligj që ta rregullonte këtë çështje, por prindërve nuk iu kërkua pëlqimi për ta bërë. Atëherë, duhet zbatuar ligji. Është shumë e thjeshtë në qoftë se lexon qoftë nenin 35 të Kushtetutës, qoftë ligjin nr. 9887, por le të mos i lexojnë, le të pyesin Zyrën e Komisionerit dhe, ashtu siç ndodhi më pas, ne i dorëzuam në Ministrinë e Arsimit. Në ata formularë ku jepeshin të dhënat e prindërve, natyrisht jepej edhe pëlqimi. Pra, u zgjidh me pëlqim dhe, natyrisht, mund të zgjidhet. Domethënë, kërkohet që gjithmonë t’i referohemi ligjit. Por shpeshherë ne konstatojmë që ka ndërhyrje në sisteme jo sipas rregullimeve që ka ligji “Për mbrojtjen e të dhënave personale”. Natyrisht, kjo duhet evituar, sepse krijon pastaj konfuzion dhe mundësi në abuzimin e të dhënave personale.

Ndoshta do të jetë shumë e vlefshme për komisionin tuaj në qoftë se ne do të arrijmë ta sigurojmë informacionin, pasi është një nga gjërat më interesante, që ne e kemi diskutuar edhe me Bordin Europian të Komisionerëve të Mbrojtjes së të Dhënave Personale (ku ne kemi statusin e vëzhguesit), është një hetim që po zhvillon autoriteti britanik në lidhje me atë që quhet ... Ai është një raport konfidencial, por në rast se ne do të arrijmë ta sigurojmë dhe në rast se do të ketë elemente të tij, që mund të bëhen publike, do të kem kënaqësinë ta vë në dispozicionin tuaj, pasi aty kuptohet më mirë se si bazat e të dhënave, se si rrjetet sociale mund të keqpërdoren edhe në funksion të përpunimit të mendjes ose të mënyrës së sjelljes së individit. Aty kishte disa elemente krejt interesante, që edhe për ne ishin krejt të panjohura më parë.

Edhe një herë, aksesit tek të dhënat personale duhet të rregullohet me ligj, por ligji duhet të respektojë parimin e proporcionalitetit dhe të mjaftueshmërisë së të dhënave. Në qoftë se për një informacion të caktuar, bie fjala, duhet të paraqitesh në bankë, aty duhen të

dhënat ekonomike ose të ardhurat që siguron, nuk ka nevojë që të të kërkojë edhe analizat e gjakut (grupin e gjakut), siç ndodh shpesh në banka që të kërkojnë edhe cilin ke komshi.

(Ilaritet në sallë)

Sepse është koncepti i mjaftueshmërisë së të dhënave, pra duhen dhënë ato të dhëna personale dhe banka duhet të përpunojë ato të dhëna personale, që lidhen me objektin e shërbimit që ofron.

Për sa i përket çështjes së certifikatave të ligjit “Për gjendjen civile”, nuk kemi pasur ankesa nga shtetasit, nuk na kanë ardhur, ndërkohë që kemi pasur ankesa nga avokatët.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vasilika Hysi – Këta janë, avokatët dhe noterët.

Besnik Dervishi – Avokatët dhe noterët nuk mund t’i zgjidhin problemet e tyre as nëpërmjet ligjit “Për të drejtën e informimit”, as nëpërmjet ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, sepse çështjet e tyre duhet t’i zgjidhin në funksion të ligjit “Për avokatinë” dhe atij “Për noterinë”. Megjithatë, ligji “Për gjendjen civile”, nuk më kujtohet neni, i ka dhënë të drejtën që, me udhëzim të përbashkët të ministrit të Brendshëm dhe të Komisionerit, të përcaktohen kategoritë e institucioneve që kanë akses të drejtpërdrejtë në Regjistrin e Gjendjes Civile.

Vazhdimisht, në bashkëpunim me ministrin e Brendshëm, kemi azhurnuar listën e institucioneve se, natyrisht, institucion është edhe avokatia, edhe noteria, pasi, pavarësisht se janë private, ushtrojnë funksione publike. Unë nuk e di nëse janë ose jo tani në këtë listë, ka një tabelë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është udhëzimi nr. 95, por ne e azhurnojmë rast pas rasti.

Në qoftë se ka një problem nga avokatia ose nga noteria, ne nuk na është bërë prezent as në takimet që kemi pasur. Le të na e bëjnë prezent problemin dhe do t’ia rekomandojmë ministrit të Brendshëm...

Specialiste – Komisionerët e kanë zgjidhur shkurt? Po bëjnë procese gjyqësore, po bllokojnë llogaritë bankare të bashkive dhe marrin gjobat. Gjobat janë marramendëse për mosdhënie informacioni.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zyrat e noterëve dhe të përmbauesve.

Besnik Dervishi – Kërkesa e fundit që ne kemi pasur ka qenë nga organet tatimore.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vasilika Hysi (?) – Po gjobisin qeverinë vendore.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Besnik Dervishi – Siç po thosha, kërkesa e fundit që ne kemi pasur ka qenë nga organet tatimore. Duke qenë se ajo është e rregulluar pikërisht në këtë udhëzim, ne i kemi kthyer përgjigje, që janë të parashikuara, pra e kanë në bazën ligjore të drejtën e aksesit në regjistrin e gjendjes civile.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për sa i përket angazhimit të Zyrës së Komisionerit, në zbatimin e Strategjisë së Drejtësisë për të Miturit, unë ju falënderoj që e vlerësoni kontributin e Zyrës së Komisionerit, por deri tani, në funksion të kësaj strategjie, nuk është se kemi pasur aktivitete konkrete, sepse duhet thënë që është edhe fillimi i saj, ama aktivitetet e Zyrës së Komisionerit kanë qenë të fokusuara, veçanërisht në fushën e mbrojtjes së të miturve, pasi ata janë shumë të prekshëm nga rrjetet sociale, dhe kjo i lidh edhe me pikën tjetër.

Siç ju thashë edhe gjatë prezantimit, ne kemi shkelur në të gjithë territorin e vendit për t'i ndërgjegjësuar të miturit pikërisht në këtë drejtim, pra veçanërisht në mbrojtjen e tyre nga rrjetet sociale, por edhe nga portalet.

(Deputeti Fino flet pa mikrofon.)

Për sa u përket ankesave nga qytetarët, nga rreth 800 ankesa që kanë ardhur deri tani, duhet thënë se 500 ankesa vijnë nga qytetarët. Ne nuk na rezultojnë ankesa, të cilave nuk u kemi kthyer përgjigje. Natyrisht, ka edhe kërkesa të qytetarëve, të cilët nuk mund të kenë përgjigje. Kemi disa raste të cilat ne përpiqemi edhe t'i konfrontojmë për hallet që ata kanë. Për shembull, rasti më i fundit ka qenë i një qytetari, i cili nuk ishte dakord me masën e pensionit dhe e kërkonte në bazë të ligjit “Për të drejtën e informimit”. Në bazë të nenit 12 të ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, ne i dhamë të drejtën e aksesit në dosjen e tij personale, iu vu në dispozicion, inspektorët tanë shkuan me të, bashkë me punonjësit e sigurimeve shoqërore, por këtu mbaron detyra e komisionerit. Në qoftë se ai nuk është i kënaqur me masën e pensionit, ky nuk është funksion i zyrës së Komisionerit.

Bledar Çuçi – Ai dyshonte se merrte më pak seç i takonte?

Besnik Dervishi – Po.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Natyrisht, për fat të keq, ngeli i pakënaqur dhe tha: “As ligji “Për të drejtën e informimit” nuk na i zgjidhka hallet”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Natyrisht, do të ketë edhe raste të tilla, por nisur nga ajo që na rezulton në shumicën e rasteve, duhet thënë se në 9 raste nga 10 të tilla, autoritetet publike nuk presin të shkojë

vendimi i komisionerit. Menjëherë sa vjen ankesa te ne, bëhet ndërhyrja nga ne qoftë me shkresë të komisionerit, qoftë me email të inspektorit, ku ia dërgojnë koordinatorit ose autoriteteve publike dhe menjëherë ato i japin përgjigje. Kjo nuk ka pse të ndodhë, sepse realisht ato duhet t'ia japin përgjigjen qytetarit që në momentin që ai bën kërkesën, jo kur bën ankesën. Por, si të thuash, është si ajo gjysma e gotës bosh. Po të shikojmë gjysmën e gotës plot, sot gati shumica e autoriteteve publike kryesore, duke filluar nga ministritë, institucionet qendrore që kanë në program transparencën, që kanë koordinator dhe regjistër, natyrisht do të kenë probleme me të drejtën e informimit. Kjo haset edhe në vende të tjera më të përparuara se ne.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Duhet thënë se treguesit janë pozitivë dhe performanca jo vetëm e Zyrës së Komisionerit, por edhe autoriteteve publike në përgjithësi vlerësohet pozitive.

Lidhur me pyetjen: “A ka probleme, se shpeshherë na thonë pse nuk gjobisni, për shembull, Kryeministrinë apo Bashkinë e Tiranës?”, për Bashkinë e Tiranës mund të ketë 100 kërkesa në ditë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bledar Çuçi – Pse në Bashkinë e Shkodrës keni gjobitur, ë?!

Besnik Dervishi – Po, ne kemi gjobitur edhe Bashkinë e Shkodrës, edhe Bashkinë e Fierit, edhe Bashkinë e Lushnjës, të Korçës...

(Nuk kuptohet mire) – Po të Durrësit?

Bledar Çuçi – Durrësi është popull i mirë.

(Kakofoni në sallë)

Këto lloj ankesash vijnë nga Tirana, ndërsa në Durrës...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Besnik Dervishi – Edhe Kurbini është gjobitur, edhe Gjirokastra...

(Ilaritet në sallë)

Edhe Saranda, edhe Vlora.

(Deputeti Fino flet pa mikrofon.)

Çfarë dua t'ju them? Të gjithë i drejtohen... Bashkia e Tiranës administron 1 milion banorë dhe mund të ketë shumë kërkesa për informacion. Duhet thënë se shumica e...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Por çfarë ndodh?

Bledar Çuçi – Ke 1 milion banorë, u merr 1 milion banorëve taksa.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Besnik Dervishi – Problemi ngrihet kështu. Në qoftë se Bashkia e Tiranës u kthen përgjigje 99 kërkesave nga 100, të gjithë...

Bledar Çuçi – Në rregull.

Besnik Dervishi – Janë disa grupime të caktuara, të cilat merren pikërisht me njëër kërkesë që ka dalë jashtë afatit. Javën e kaluar kishim seancë dëgjimore në Bashkinë e Tiranës për dy çështje, ku kërkoheshin të gjitha prokurimet e kryera nga viti 2013 deri në vitin 2018.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bledar Çuçi – Nuk ka përgjigje... Përgjigje e kualifikuar...

(Inçizim i dobët)

Besnik Dervishi – Çdo institucion që të ishte, edhe sikur të mobilizoheshin dhjetë veta, të paktën do u duhej një muaj që të vlerësonin të gjithë dosjen...

Bledar Çuçi – Si trajtohet kjo? Nuk trajtohet si moskthim përgjigjeje, se ti nuk i kthen përgjigje, thua: për këtë që më ke pyetur, kam nevojë për gjashtë muaj kohë.

Besnik Dervishi – Çfarë ndodh? Kryesisht, këto janë projekte, që i përfitojnë grupe të caktuara të shoqërisë civile dhe atyre u intereson... Ligji thotë: për dhjetë ditë. Ka të drejtën ta shtyjë maksimumi edhe pesë ditë të tjera.

(Inçizim i dobët)

...Kanë dale nga afati, unë kërkoj të..... ne përpiqemi...

(Incizim shumë i dobët)

Specialist - kjo është një çështje që duhet të zgjidhet në parim... e quani ju përgjigje një përgjigje që i kthen Bashkia e Tiranës në rastin konkret një të interesuari, ku i thotë që për kërkesën tuaj....

(Diskutime pa mikrofon)

Kjo quhet....

(Incizim shumë i dobët)

...këtë analizë, këtë përgjegjësi e ka marrë përsipër ta kryejë zyra e Komisionerit, pa i hequr të drejtën ankuesit t'i drejtohet gjykatës, pornë seancë dëgjimore apo në inspektim në vend, pranë autoritetit publik është e pamundur objektivisht që të realizohet brenda afateve që parashikohen në ligj. Ne e kemi zgjidhur çështjen me konsensusin e palëve.....autoritetit publik i është dhënë koha e nevojshme..... sipas parashtrimeve që janë bërë.....nga kjo dhe në shumicën e rasteve.....konsensusi..... Unë mendoj që edhe qëllimi i ligjit nuk është centralizimi i Nëse bashkia vendos që

Ne kemi gjetur një konsensus dhe më duhet të them se nuk kemi pasur asnjë rast..... në gjykatë ku të jemi.....

Unë e thashë edhe më sipër se ka raste të cilat ne i kemi.....nuk ka një.....

Gjykata administrative.....

(Incizim shumë i dobët)

Bashkim Fino - Unë kam një pyetje teknike, por kamDuke dëgjuar të famshmin dekriminalizim.....personat që nuk zgjidhen për shkak të.....çfarë bëhet me ta? Unë jam një person që dua të kandidoj.....

(Incizim shumë i dobët)

Ja çfarë do të thotë të bësh një monitorim në terren, pra të shkosh..... kushtetues apo.....në parlament.

Edhe në kuadër të rregullores së re..... presupozohet qëtë ketë një strukturë tjetër pune..... 3 javë në muaj dhe 1 javë..... nga institucionet përkatëse.

Në takimin e parë që bëmë.....sa shumë pyetje diskutime, informime.....si Komisioni i Ligjeve.....siç ka qenë praktika 2-3 herë në vit, një herëpër raportin..... bëheshin disa pyetje dhe kalonte në mënyrë rutinë dhe një herë vinit kur bëhej buxheti, ku kërkonipër probleme financiare se sa teknike. Në takimet që do të zhvillojmë t'i bëjmë.....të na krijoni mundësinë.....edhe aktivitetin e punës suaj.....për të zgjidhur hallet, problemet që ju keni gjatë procesit.....të mos shikohemi vetëm 2 herë në vit, një herë kur vjen raporti, kur raportohet dhe një herë për buxhetin.....

Ka të bëjë pikërisht me.....ne duhet të ne duhet të takohemi më shpesh, ndoshta edhe komisioni ynë duhet të jetë specifike...dy tre grupe mund të merren me një komisioner, dy tre të tjerë me një komisioner tjetër.....Unë për shembull..... Komisionerin për të Dhënat Personale, dy kolegët e mi, të merren me Avokatin e Popullit.....

I gjithë kontrolli që bëhet.....ka të bëjë..... sa mirë folët ju për të gjithë problematikën që keni pasur edhe në arenën ndërkombëtare apo edhe për konferencën.....në tetor të vitit që vjen që është një konferencë, e cila ia vlen..... punën që ke bërë.....në Shqipëri, por edhe.....

...të Komisionit të Ligjeve, jo thjeshtmos na keqkuptoni në sensin vulgar të fjalës, por nëse ne i kemido të thotë që ai duhet të dijë të gjithë

aktivitetin tuah.....Është në nderin tënd, kur nesër të vijmë të jetë Presidenti i vendit, Kryeministri, deputetë..... ti do të krenohesh dhe do të thuash se e kam të gjithë shtetin..... mbështetje dhe si komisioner. Në këtë aspekt ne duhet të kemi në vazhdimësi takime dhepër të zgjidhur problemet që

Problemet për projektligjin që duhet të ndryshohet.....ka raste.....

(Incizim shumë i dobët)

Fakti që për..... se unë kam disa gjëra për të ndryshuar.....edhe ne duhet të jemi të ndërgjegjshëm kur të bëjmë një projektligj dhe kur bëjmë ndryshimet përkatëse.....bëjmë një ligj.....për 15 vjet, për 20 vjet.....që t'i rezistojë kohës, pavarësisht seqë të bashkëpunojmë.....në këtë aspekt, zoti kryetar, bëme shumë mirë qëdo të vazhdojmë edhe gjatë janarit monitorimin e këtyre institucioneve.....për të bërë të mundur që ne të jemi sa më afër problemeve të tyre dhe që të kuptojmë edhe ne se çfarë bëhet me to..... dhe jo vetëm dy herë në vit, një herë për informacionin dhe herën tjetër për problemet financiare.....

Vërejtjet dhe diskutimet për buxhetin.....sensibilizimi.

(Incizim shumë i dobët)

Për mua që jam i deputet i vjetër, e kam votuar këtë ligj.....ty të kam edhe mik, por nuk shikoj..... që do të thotë se sensibilizimi është shumë i domosdoshëm, jashtëzakonisht shumë i domosdoshëm..... sepse..... dhe nuk dinë deputetët se për çfarë është Komisioneri për të Dhënat Personale..... ta them unë, imagjinoni ta dinë pjesa tjetër e shoqërisë se si funksionon ky Komisioner. Të jeni i bindur se..... çfarë të drejta ke ti, çfarë të drejtash kam unë.....do të thotë se sensibilizimisidomos në organet e qeverisjes vendore është shumë i domosdoshëm.

Ju thatë se nuk ka..... si e mendoni.....nëse krijojmë disa.....që sensibilizojmë opinionin.....thjesht të marrin informacion.....

(Incizim shumë i dobët)

Komisionerët e tjerë.....mund të krijojnë zyra në çdo bashki, që 2-3 vetë të kryejnë punët.....qoftë për Avokatin e Popullit, të Komisionerit për të Dhënat Personale.....

Mbaroi historia.atëherë pse duhet të..... bashki..... nëseke një zyrë atje.....ai është i interesuar që të japë informacione, të kthejë përgjigje e të tjera.

(Incizim shumë i dobët)

.....dhe kur e them unë që jam deputet në Komisionin e Ligjeve që minimalisht takohemi 2 herë në vit, imagjino.....Komisioni i Ekonomisë, Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese apo.....

Kjo ështëkryetarin e Komisionit që pas një..... të bëjmë një

(Incizim shumë i dobët)

Besnik Dervishi.....shpesh herë ndihemi të pa.....Ne jemi të gatshëm që me ndihmën tuaj, të kryetarit të Komisionit të Ligjeve.....një trajnim, qoftëpër të dhënat personale, jo vetëm me stafinpor edhe me deputetët.....

Për sa i përket përfshirjes së deputetëve në..... kemi aplikuar dhe shumë shpejt një projekt dhe shpresojmë që do të miratohet Ne kemi paraqitur që nevoja jonë është që ne të ndërgjegjësojmë edhe institucionet e tjera.

Kjo rregullore nuk ka detyra vetëm për zyrën e Komisionerit, por ka edhe për disa institucione të tjera, për Ministrinë e Brendshme deri te Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit.

Ne këtë punë nuk mund ta realizojmë pa ndihmën e Komisionit të Ligjeve. Kemi sjellë kërkesën që një grup i shoqëruar nga stafi i zyrës së Komisionerit të zhvillojmë një vizitë studimore disa ditore në Bruksel ku të njihemi me që prodhon..... jo vetëm për BE-në, por..... vende të treta po përpunohen të dhënat.....ka..... për Shqipërinë.

(Incizim shumë i dobët)

Për sa i përket dekriminalizimit ne jemi me një qëndrim për këtë që ju përmendët, për ata të cilët kanë mbaruar për të cilin është bërë publik..... është plotësuar dhe është publik formulari i dekriminalizimit, ai nuk ka më pse të jetë, të qëndrojë. Kemi pasur njënë..... administratës publike, ku napër një person që nuk ishte më në shërbimin civil, ishte larguar nga shërbimi civil, shkaku për të cilin

deklaratë dekriminalizimi nuk ka pse të jetë më publike. Të njëjtën gjë kemi pasur edhe në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, jemi shprehur disa herë për formularin e dekriminalizimit....

Koncepti tjetër që ne kemi trajtuar ka qenë mjaftueshmëria e të dhënave. Qëllimi i ligjit është pastërtia e figurës. Aty kishte edhe të dhëna të tjera ...*(Nuk dëgjohet)*

Ne mbajtur qëndrimin që nuk ka pse të bëhen publike. Natyrisht që mund të jenë në formularë, por jo pjesë e formularit që duhet bërë publik.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Dervishi!

Nuk besoj se ka pyetje të tjera nga kolegët.

Nëse do t'i mbarojmë të gjitha pyetjet sot, i bie që të mos vijmë më vitin tjetër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në fund fare komisioneri ka dëshirë të shfaqë edhe një ... për efektivitetin e zbatimit të fondeve që ka dhënë buxheti i shtetit ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dua të them edhe unë dy fjalë për qëllimin e vizitës.

E thashë në fillim të fjalës që është një aspekt shumë i rëndësishëm i veprimtarisë parlamentare të Komisionit të Ligjeve çështja e kontrollit parlamentar. Është e vërtetë që e drejta për informim dhe e drejta për privatësi janë kategori shumë të rëndësishme kushtetuese, që meritojnë vëmendjen e duhur nga komisioneri dhe nga Komisioni i Ligjeve, por e rëndësishme është sensibilizimi. Veprimtaria e institucionit që ju drejtoni ka dy dimensione: dimensionin ligjor, që natyrisht ... një lloj ndryshimi ligjor që ju kërkon ... qoftë për ligjin për të drejtën e informimit, qoftë për ligjin e mbrojtjes të të dhënave personale, ... për shkak të boshllëqeve të krijuara nga zbatimi në praktikë i këtyre dy ligjeve, aq më tepër që janë ligje të reja. Dimensionin e dytë është ai i zbatimit në praktikë të këtyre ligjeve, sepse janë dy të drejta kushtetuese që meritojnë vëmendjen e duhur, aq më tepër kur e drejta për informim dhe mbrojtja e të dhënave personale ... Me gjithë punën që bën komisioneri, jam i bindur që këtu ka goxha probleme për mbrojtjen e të dhënave personale apo privatësinë e individëve.

Për shembull, sistemi TIMS. Jam i bindur që nëse ligji për mbrojtjen e të dhënave personale do të zbatohet si duhet dhe nëse do të ketë monitorimin dhe mbikëqyrjen e duhur nga ana e komisionerit, aty ka elemente të veprës penale ku shumë subjekte, që, për shkak të ligjit janë detyruar të ruajnë sekretin, e kanë kthyer në një mjet biznesi.

Jam i bindur që në çdo zyrë prokurorie dhe të Policisë së Shtetit, pavarësisht se kush hyn në sistemin e gjurmës, nxjerrin të dhënat personale të lëvizjet e qytetarëve shqiptarë brenda dhe jashtë Shqipërisë dhe jua japin mediave apo portaleve. Pra, vetë institucionet apo subjektet që kanë për detyrë t'i ruajnë, janë kthyer në një mjet sulmi ndaj individëve të caktuar, qoftë zyrtarëve të lartë publikë apo edhe qytetarëve të zakonshëm.

Ndoshta sot kuptoni që është e pamundur të mbikëqyret si duhet zbatimi i dy ligjeve nga ana e komisionerit për shkak të mungesës së stafit. Nga ky raportim del që nuk janë në dispozicion të zyrës burimet e nevojshme njerëzore për ta ushtruar siç duhet

këtë gjë. Nuk e di sa subjekte janë denoncuar apo kallëzuar për ndjekje penale për shkak të shkeljes së ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale. Ju thoni që puna e komisionerit mbaron me vendosjen e një ndëshkimi me gjobë, por ndoshta nëse e kemi lënë në ligj që këtu mbaron puna juaj me vendosjen e një gjobe ndaj subjekteve që abuzojnë me të dhënat personale, atëherë propozoni ndryshimin ligjor në Komisionin e Ligjeve që t'i japim një dimension tjetër kësaj gjëje. Një oficer i Policisë Gjyqësore që ka akses në sistemin TIMS merr një porosi nga telefoni, ku i thuhet të printojë (po e marr kolegun Fino për referencë), lëvizjet e vitit 2018 të zotit Fino për muaj janar-nëntor nga ka lëvizur për hallet e tij personale. Më pas do t'i shikojmë në portale. Ndaj, unë e shikoj shumë të rëndësishëm dimensionin e mbikëqyrjes konkretisht të ligjit. Jam shumë dakord me ato që tha kolegu Fino. Kur flitet për deputetë që nuk kanë njohuri për dy ligjet me të cilët ju operoni, jam i bindur që në administratën publike jo e jo.

Thatë që keni bërë fushata sensibilizimi me shkollat, pushtetin vendor e të tjera. Unë mendoj që ndoshta përveç kontakteve, seminareve, konferencave dhe workshopeve që ju keni zhvilluar në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, të ketë një zë të posaçëm edhe për të drejtën e ...

Ju duhet t'i bëni publikim të herëpashershëm në media punës së institucionit tuaj. Njerëzit duhet të dinë pozicionin e komisionerit që të vijnë të ankohen.

Nuk po them që të jetë çdo ditë në media, por duhet t'i bëhet reklamë punës së institucionit. Shumë pak njerëz mund ta dinë që në Shqipëri ka një Komisioner për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe të Drejtën e Informimit. Për Komisionerin e Mbrojtjes nga Diskriminimi kam përshtypjen se nuk e di njeri fare që ekziston.

Edhe kaq sa është bërë në këtë zyrë, unë jam i bindur që është bërë për shkak të impenjimeve të komisionerit, për shkak të punës tënde si besnik për ta promovuar institucionin që drejtoni.

Është jashtëzakonisht shqetësuese ...

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Jo vetëm që nuk e njohin, por edhe gjendja e të drejtës së informimit dhe të mbrojtjes të të dhënave personale është alarmante. E them sinjerisht që kjo vizitë ia vlejti për të parë rëndësinë që ka puna e institucionit që ju drejtoni. Komisioni i Ligjeve është i gatshëm të japë të gjithë suportin e duhur. Zoti Fino hodhi idenë që meqenëse janë shumë institucione varësie në fushën e përgjegjësisë së Komisionit të Ligjeve ne mund të bëjmë një ndarje të punës ndërmjet deputetëve që ka komisioni. Në kuadër të nënkomisioneve që kemi ne e kemi shumë të lehtë ta bëjmë këtë. Nënkomisioni i të

drejtave të njeriut mund të bëj një ndarje të punës brenda deputetëve: kush do të mbulojë mbikëqyrjen dhe monitorimin e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe të Mbrojtjes të të Dhënave Personale, Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Komisionerin për Shërbimin Civil e me radhë.

Ndoshta edhe ne si Komision i Ligjeve duhet të bëjmë më tepër për publikimin e punës që zhvillon ju si institucione varësie. Aq të gjerë e keni dimensionin e punës që do të duhet të zhvillon si institucion sa jam i bindur që, nëse ne do të bëjmë bashkarisht përpjekje për të garantuar si duhet mbrojtjen e të dhënave personale dhe të drejtën e informimit, do të kemi përmbushur një funksion shumë të rëndësishëm që ka qoftë Komisioni i Ligjeve, por edhe ju si komisioner. Është alarmante.

Ju thoni që nuk është titull ekzekutiv gjë që ju vendosni ...vendimi juaj për të drejtën e informimit. Kjo duhet të kishte qenë diku. Siç e keni vendimin për mbrojtjen e të dhënave personale, duhet ta kishim edhe për të drejtën e informimit, sepse janë dy të drejta që nuk rivendosen ndryshe, në rast se institucionet nuk e ndiejnë peshën e dëmit që shkaktojnë nga moszbatimi i ligjit.

Specialist - Vendimi për bërje transparence nuk është titull ekzekutiv.

Ulsi Manja - Kështu që, edhe një herë ju falenderoj për pritjen që na bëtë sot në institucionin tuaj!

Kemi prekur nga afër punën e një institucioni ...

Nëse Besniku do të vij për buxhetin e vitin 2019 dhe do të kërkojë para për çështje të ndryshme, ...

Me gjithë dëshirën e mirë që ju keni si staf keni për ta bërë të mundur, unë shikoj që burimet njerëzore janë të domosdoshme. Aq më tepër që nuk keni zyra vendore. Bashkë me Avokatin e Popullit, që ka zyra vendore dhe Komisioneri për Parandalimin, mund të bëni marrëveshje që t'i përdorni si zyra respektive.

Zoti Dervishi, shumë faleminderit ju dhe stafit tuaj!

MBYLLET MBLEDHJA

Sekretare
Klotilda Bushka (Ferhati)

Përgjegjëse e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretare e komisionit
Edlira Rama

